



GROUP FOR LEGAL
AND POLITICAL
STUDIES



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Manual

rreth mekanizmave ligjorë
për **raportim të dhunës**
në baza gjinore dhe
qasja në ndihmën
juridike falas

Pse duhet të luftohet dhuna ndaj grave dhe vajzave?

- Fuqizon barazinë gjinore dhe sociale;
- Nxiti zhvillimin social dhe ekonomik;
- Parandalon format e tjera të diskriminimit, përfshirë diskriminimin në bazë të aftësive të kufizuara, moshës, racës, orientimit seksual, etj;
- Mbështet qasjen e barabartë të grave në arsim, mundësi për punë, të ardhura më të mira;
- Përmirëson mirëqenien e shoqërisë në përgjithësi;

1,700

Raste të reja të dhunës familjare janë regjistruar në 2019



Gjatë vitit 2018, kanë lindur 9.985 foshnje, prej të cilave

65 nga nënat e moshës jo-madhore.

Në Kosovë ndodhin rreth

80



martesa të hershme – nën moshën 16 vjeçare.

Në 10 dekadat e fundit në Kosovë janë vrarë

34


gra dhe vajza nga burrat, baballarët apo djemtë e tyre.

59%

të viktimave seksuale janë të moshës prej 11 deri 16 vjeç

2%

e grave kanë raportuar për dhunë të ushtruar nga partneri aktual në Policinë e Kosovës.



Raportimi i Dhunës në Familje në polici:



Në 2018, në Prishtinë u raportuan 442 raste, në Prizren 251 raste, në Gjilan 211 raste. Një studim i kryer nga GLPS dhe partnerët zbulon se gjatë vitit 2017, ishin gjithsej 1,299 raste të dhunës në familje të raportuara në Policinë e Kosovës, duke e bërë dhunën në familje formën më të përhapur të dhunës me bazë gjinore të raportuar në Kosovë. Nga gjithsej, 76.21% e rasteve të raportuara janë nga gratë të moshave të ndryshme me rastet e mbetura të raportuara nga burrat.

Si e përcakton korniza ligjore e Kosovës dhunën me bazë gjinore, dhe cilat janë mekanizmat mbrojtës që i ofron?

Republika e Kosovës ka zbatuar ligje të ndryshme dhe mekanizma të tjerë legjislativ me qëllim të adresimit të dhunës me bazë gjinore, dhe të ofrojë mbrojtje për viktimat e kësaj lloji dhune. Disa nga mekanizmat ligjorë shpjegohen më poshtë:

Ligji për Barazinë Gjinore ‘garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë.’

Neni 3.1.12 – Ngacmimi seksual – nënkupton çfarëdo forme të sjelljes së padëshiruar verbale, jo verbale, apo fizike me natyrë seksuale, me qëllim apo pasojë prekjen apo shkeljen e dinjitetit të një personi, dhe për të krijuar një mjedis frikësues, armiqësor, degradues, poshtëruës apo fyes.

Neni 3.1.18 – Dhuna në baza gjinore – nënkupton të gjitha aktet e dhunës që rezultojnë apo kanë të ngjarë të rezultojnë në dëmtim apo vuajtje fizike, seksuale, psikologjike, sociale apo ekonomike në baza gjinore, duke përfshirë kërcënime për akte të tilla, shtrëngim, apo heqje arbitrare të lirisë, qoftë kur kjo ndodh në jetën publike apo private.

Neni 4.2 – Dhuna në baza gjinore është një formë e diskriminimit e cila seriozisht pengon aftësinë e femrave dhe meshkujve që t’i gëzojnë të drejtat dhe liritë në baza të barabarta dhe është e ndaluar.

Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje - Ky ligj ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes, që janë viktimat e dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.

Neni 2.1.2 – Dhuna në familje – një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bëjnë një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare.

Neni 2.1.3 – Pala e mbrojtur – personi ndaj të cilit është ushtruar dhuna në familje dhe vartësit në dobi të të cilit është kërkuar urdhri për mbrojtje, urdhri për mbrojtje emergjente ose urdhri për mbrojtjen e përkohshme emergjente.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Neni 248) – Dhuna në familje – Kushdo që e kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër Brenda një marrëdhënieje familjare, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në 3 (tre) vjet.

Ku mund të raportoni dhunën me bazë gjinore dhe forma të tjera të dhunës?

- Policia e Kosovës
- Inspektorati i Policisë / Departamenti i Hetimeve
- Prokurori i Shtetit
- Qendra për Punë Sociale
- Gjykatat
- Agjencia për Ndihmë Juridike Falas – ANJF
- Institucioni i Avokatit të Popullit - IAP

Policia e Kosovës

Në të shumtën e rasteve është kontakti i parë për viktimën e dhunës në familje.

Zakonisht policia thirret kur një rast i dhunës në familje ka ndodhur rishtazi ose është i pashmangshëm.

Prandaj, detyrë parësore e policisë është të hetoj rastin dhe të mbrojnë viktimën. **Policia e Kosovës** si reaguesit e parë të zakonshëm kanë një detyrim për të dhënë informacion viktimave, t'i udhëzojnë viktimat gjatë procesit dhe të njoftojnë akterët tjerë.

Policia e Kosovës është përgjegjëse sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për të ekzekutuar *urdhrin e mbrojtjes dhe urdhrin e mbrojtjes emergjente dhe për të zbatuar urdhrin e përkohshëm emergjent*.

 Raportimi i dhunës në Policinë e Kosovës

 Telefoni: **192**

 Linja falas dhe konfidenciale: **0800 19999**

 info@kosovopoliice.com

Rastet e dhunës mund të raportohen edhe përmes shkuarjes direkt në stacion policor.

Për më shumë informata vizitoni webfaqen e Policisë së Kosovës:


www.kosovopoliice.com



Inspektorati i Policisë / Departamenti i Hetimeve

Inspektorati i policisë/departamenti i hetimeve ka një rol special në ndihmën ndaj viktimave të dhunës në familje. Roli i kësaj njësie në ndihmën për viktimat e dhunës në familje vjen në shprehje kur një akti i dhunës në familje është kryer nga një punonjës i policisë së Kosovës. Për këtë arsye, kjo njësi nuk do të ketë kontakt aq të shpeshtë me viktimat sa do të kenë akterët tjerë. Megjithatë kjo njësi ka një përgjegjësi të madhe për t'i mbrojtur viktimat nga kryesit e dhunës në familje. Anëtarët e inspektoratit të policisë duhet të marrin rolin e policit dhe t'i ofrojnë informata viktimave, udhëzojnë ato gjatë procesit dhe poashtu t'i njoftojnë akterët tjerë.

 Raportimi i dhunës në Inspektoratin Policor

 'Linja e kaltër' pa pagesë: **080003333**

 info.ipk@rks-gov.net

Gjithashtu një mënyrë tjetër e kontaktimit është përmes mesazhit në webfaqen e inspektoratit në fushën kontakti:

ipk.rks-gov.net/kontakti

Prokurori i Shtetit

Bashkëveprimi në mes të Prokurorit dhe viktimës së dhunës në familje zakonisht vjen në shprehje në procesin e mëvonshëm të raportimit. Prokurorët i vlerësojnë rastet e dhunës në familje dhe shkeljet e urdhërave mbrojtës për të përcaktuar nëse ka prova të mjaftueshme për t'i ndjekur kryesit e dhunës në familje.

Prokurori ka për obligim që të informojë viktimën lidhur me statusin e rastit të saj/tij.

Cilat janë mekanizmat e tjerë brenda zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit që ofrojnë ndihmë për viktimat?

Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave – Ofron shërbime për viktimat e krimit gjatë procedurave ligjore dhe përfaqëson interesat e tyre në sistemin e drejtësisë penale në Kosovë. Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave është e pavarur brenda Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. ZMNV është përgjegjëse për të siguruar që politikat e ZMNV-së të jenë në pajtim me politikat e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial.

Brenda Zyrës për Mbrojtje dhe Ndhimë viktimave ekziston edhe Zyra e Linjës Ndhimëse

Zyra e Linjës Ndhimëse – ‘është numër telefonik publik dhe pa pagese për t’ua mundësuar viktimave dhe publikut një mekanizëm konfidencial për raportimin e veprave të ndryshme penale të abuzimit: për informimin e viktimave dhe personave tjerë lidhur me të drejtat e tyre, sigurimin e informatave të nevojshme për shërbime ekzistuese dhe numrat kontaktues.’



Prokurori i Shtetit



Numri i Linjës Ndhimëse, **falas 24 orë: 080011112**

**Për më shumë informata vizito webfaqen e Kryeprokurorit të shtetit:
www.psh-ks.net/sq/prokurori-i-shtetit**



Strehimoret për viktimat e dhunës në familje

Strehimoret i ofrojnë viktimave një vend të sigurtë për të jetuar pas përjetimit të rastit të dhunës në familje. Viktimat mund të kërkojnë ndihmë nga një strehimore drejtpërdrejtë ose mund të referohen në strehimore nga një ofrues tjetër i shërbimeve. Strehimore janë vendbanime të përkohshme që ofrojnë jo vetëm mbrojtje për viktimën por edhe e ndihmojnë viktimën në procesin e rekuperimit nga dhuna në familje dhe rehabilitim e reintegrimin e viktimës në shoqëri.

Qendra për Punë Sociale

Qendra për Punë Sociale është institucion publik i nivelit komunal, kompetent për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë për shërbime sociale dhe familjare, në këtë kontekst edhe mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje deri në ri-integrim të viktimës. Gjithashtu koordinon aktivitetet me akterët tjerë në procesin e mbështetjes së viktimës dhe fuqizimit të saj/tij. Qendra për punë sociale (QPS) ndihmon viktimat e dhunës në familje kur nevojiten shërbimet sociale, mbrojtje, rehabilitim dhe integrim të viktimave në shoqëri. Çdo viktime të referuar i caktohet një menaxher i rastit, i cili është zyrtar që emërohet nga QPS për të ndihmuar në identifikimin dhe koordinimin e shërbimeve ekzistuese.

Gjykatat

Gjykatat i shqyrtojnë me prioritet rastet e dhunës në familje. Këto raste trajtohen nga gjykata në procedurë civile apo penale varësisht nga natyra e rastit. Në raste të rralla gjykatat janë ofruesit e parë të shërbimeve që ballafaqohen me viktimën e dhunës në falmije. Edhe pse gjykata nuk inicon procedurat lidhur me rastet e dhunës në familje, gjykata nuk është pasive në obligimet e saj ndaj rasteve të dhunës në familje. Gjykatat, kanë përgjegjësinë e trajtimit të palëve dhe individëve që shfaqen para tyre, në mënyrë të paanshme, dinjitoze dhe respekt, duke siguruar mbrojtje adekuate për të gjitha palët e përfshira në procedurë.

Ligji për mbrojtje nga Dhuna në Familje i mundëson viktimave që të kërkojnë **urdhrat mbrojtës për aktet e dhunës në familje**. Urdhrat mbrojtës parashtrohen në juridiksionin ku viktimat ka vendbanim apo venqëndrim dhe lëshohen në bazë të Nenit 3 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Për të parashtruar kërkesën për urdhërmbrojtje viktimat mund të kërkojnë ndihmë nga: Mbrojtësit e Viktimave, QPS-të, Zyra për ndihmë Juridike dhe OJQ-të e ndryshme që ofrojnë shërbime të tilla. Për parashtrimin e një kërkesë të tillë nuk ka nevojë të paguhet taksë gjyqësore dhe viktimat nuk kanë nevojë të angazhojnë avokat.

Ky urdhër lëshohet pas mbajtjes së një seance ndëgjimore dhe kur:

- ekzistojnë fakte që i mbështesin dyshimet e arsyeshme se kryesi mund të kryejë ndonjë akt të dhunës në familje;
- lëshimi i urdhërit të mbrojtjes është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës

Ekzistojnë 3 lloje të Urdhrave Mbrojtës, dy prej tyre lëshohen nga gjykata. Urdhri i tretë mund të sigurohet jashtë orarit të punës së gjykatave.

Urdhër Mbrojtje - urdhëri i lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën. Kohëzgjatja e urdhërit për mbrojtje nuk mund të jetë më e gjatë se 12 muaj por me mundësi vazhdimi jo më shumë se 24 muaj.

Urdhër Mbrojtje Emergjente - urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykate. Kohëzgjatja e urdhërit për mbrojtje emergjente skadon në fund të dëgjimit për vërtetimin e urdhërit për mbrojtje emergjente.

Urdhër Mbrojtje e Përkohshme Emergjente - urdhri i lëshuar jashtë orarit të punës së gjykatave nga Shefi i njesitit Rajonal të Policisë së Kosovës kundër dhunës në familje. Kohëzgjatja e urdhërit të përkohshëm emergjent skadon në fund të ditës së ardhshme gjatë së cilës gjykata punon

Raporto dhunën – Institucionet që ofrojnë ndihmë juridike falas dhe asistencë juridike

Në raportimin e çfarëdo forme të dhunës është e rëndësishme të dihet roli i institucioneve të ndryshme. Prandaj, institucione të ndryshme në Kosovë ofrojnë ndihmë dhe ekspertizë juridike në trajtimin e rasteve të ndryshme të dhunës.

Agjencia për Ndhmë Juridike Falas – ANJF

Ndihma juridike në Kosovë është institucionalizuar në maj 2006 me themelimin e Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas, e cila është e para dhe e vetmja e këtij lloji në Evropën Jug-Lindore. Ajo ofron dhe siguron një qasje të barabartë në drejtësi për qytetarët e Republikës së Kosovës, duke afirmuar kështu gatishmërinë e institucioneve të Kosovës për promovimin, respektimin dhe mbrojtjen e parimeve të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit në Kosovë. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) “Ndhma juridike falas do t’u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtës”. Sidoqoftë, ekzistojnë disa kushte/rregulla për të përfituar ndihmë juridike falas prej ANJF.



Ndihma juridike falas i ofrohet të gjithë personave të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara si në vijim:

- 1) Kriteri kualifikues;
- 2) Kriteri financiar;
- 3) Kriteri Juridik

Ndihma juridike ofrohet në rastet: *Në qoftë se jeni në gjendje materiale që ju bën të pamundur të zgjidhni problemin tuaj, dhe nuk mundeni të angazhoni avokatin privatisht, sepse: - nuk i realizoni të ardhurat - jetoni nga ndihma sociale - jeni pensionist - i realizoni të hyrat mujore me të vogla se të ardhurat mesatare në vend Ju e përmbushni kriterin financiar, për të përfituar nga ndihma juridike falas.*

ANJF ofron këto shërbime:

- Informata dhe këshilla ligjore rreth procedurave ligjore;
- përpilimin e shkresave dhe tërë ndihmën tjetër teknike që ka të bëjë me kompletimin e lëndës;
- në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse;
- mbrojtjen dhe përfaqësimin në të gjitha fazat e procedurës penale;
- informatat dhe këshillat juridike lidhur me procedurat kundërvajtëse;
- informatat, këshillat juridike dhe ndihma në procedurat e ndërmjetësimit, arbitrazhit ashtu siç është paraparë me ligjet në fuqi.

Ndihma juridike falas ofrohet tek përfituesit:

- nëse keni probleme nga marrëdhënia familjare,
- nëse keni çështje të pazgjidhura pronësoresh juridike,
- nëse keni probleme nga marrëdhënia e punës,
- nëse dikush është në marrëdhënie detyimore me ju,
- nëse keni kërkesa që duhet zgjidhen te organet administrative,
- nëse duhet të zhvillonin procedurë gjyqësore, ose dikush po zhvillon procedurë gjyqësore kundër jush,
- nëse jeni të arrestuar apo të paraburgosur.

Ku mund t'i gjeni zyret e ANJF-së?

Prishtinë

Adresa: Rr. Zenel Salihu nr 30 – Prishtinë
Kontakti: **038/200 18 944; 38/200 18 941**

Prizren

Adresa: Objekti i Prokurorisë Themelore Prizren
Kontakti: **029/230 554; 029/230 554**

Pejë

Adresa: Rr. Bukuroshes nr. 8 Pejë
Kontakti: **039/423 698; 039/423 698**

Mitrovicë

Adresa: Sheshi Isa Boletini nr. 27, Mitrovicë
Kontakti: **028/534 477; 028/534 477**

Gjilan

Adresa: Objekti i Prokurorisë Themelore Gjilan
Kontakti: **0280/321 134; 0280/321 134**

Për më shumë informata vizito webfaqen e ANJF-së:
anjf.rks-gov.net

Institucioni i Avokatit të Popullit - IAP

“Institucioni i Avokatit të Popullit paraqet mekanizmin ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve tjera, të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës, si dhe vepron si Mekanizëm Kombëtar për parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut.”

- Avokati i Popullit është mekanizëm i barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë pa diskriminim në bazat e mbrojtura nga Ligji për barazi gjinore dhe Ligji për mbrojtje nga diskriminimi, të cilat ligje, bashkë me Ligjin për Avokatin e Popullit përbëjnë pakon ligjore të të drejtave të njeriut, e cila ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2015.
- Avokati i Popullit është një institucion i pavarur që nuk pranon ndonjë ndërhyrje nga jashtë.
- Avokati i Popullit zhvillon hetime, jep rekomandime, publikon raporte, si dhe avokon për të drejtat dhe liritë e njeriut.
- Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.
- Avokati i Popullit nuk merret me hetimin e çështjeve, që kanë të bëjnë me kontestet që zhvillohen ndërmjet personave privat. Gjithashtu shërbimet e IAK janë falas.



Ju mund të raportoni raste në Institucionin e Avokatit të Popullit përmes thirrjes falas në: **080015555**



Kontaktit në numrat zyrtarë:

+383 (0) 38 223 782; +383 (0) 38 223 783;
+383 (0) 38 223 784; +383 (0) 38 223 78;



info.oik@oik-rks.org

Adresa e selisë qendrore: Institucioni i Avokatit të Popullit, Rr. "MIGJENI", nr. 21 10000 Prishtina, KOSOVA

Zyret e IAP gjenden në: Prishtinë, Prizren, Gjilan, Pejë, Mitrovica e Jugut, Mitrovica e Veriut, Ferizaj, Gjakovë, Gracanica

Për më shumë informacione vizitoni webfaqen:

www.oik-rks.org

Më shumë për të drejtat e tua

- Mëso më shumë rreth të drejtave të tua dhe rolin e institucioneve në platformën: E drejta jem: **edrejtajem.org/ballina**
- Reporto shkelje në platformën: Know Your Rights **knowyourrightsks.org/en/about**



GROUP FOR LEGAL
AND POLITICAL
STUDIES



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA